

## ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër **KUVENDIN KOMUNAL TE DRAGASHIT**

Nr i Prokurimit	621-21-2979-5-2-1
Nr i brendshëm	621-2021-031-521

Sa i përket tenderit për: “Punimi dhe rregullimi i rrjetit furnizuese te ujësjellësit nga burimi në Kleq deri te rezervoari në fshatin Pllavë (projekt dy vjeqar)“.

### 1. Identifikimi i OPERATORIT EKONOMIK

**“PUNA” SH.P.K**

(Emri i Operatorit Ekonomik)

Rr. Tahir Sinani, Blloku C2/B-Prizren

(Adresa)

Prizren,

(Vendi)

20000

(Kodi postar)

+383 49 230 351

(Numri Telefonit)

(Numri i Faks-it)

Vahidin Halili

(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

nnp\_puna@hotmail.com

(Adresa elektronike)

**10.06.2021**

(Data e parashtrimit të ankesës)



## 2. Identifikimi i avokatit

*Parashtruesi i kërkesës mund ta parashtroj kërkesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse kërkesa parashtron përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.*

*Shëno të dhënat si në vijim:*

*(Emri i avokatit)*

*(Adresa e plotë)*

*(Numri i Telefonit)*

*(Numri i faks-it)*

*(Adresa elektronike)*

*(Data e parashtrimit të ankesës)*

*(Nënshkrimi dhe vula)*

## 3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

*[Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vedin në të cilën është publikuar "Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës", "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimi për anulim te aktivitetit te prokurimit", nëse aplikohet, qafat e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës].*

Njoftimi për kontratë: 19.05.2021

Afati i fundit për dorëzimin e tenderit: 14.06.2021

Kërkesa për rishqyrtim dt:07.06.2021

Vendimi mbi refuzimin e kërkesës për rishqyrtim dt:08.06.2021

## 4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

*A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht securinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.*

Po

Jo

## 5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

*A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit?*

Po

Jo

## 6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkese për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po

Jo

## 7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njofimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njofimit për Dhënier e Kontratës apo Njofimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njofimit për Anulim.

Neni 1 i LPP-së

Neni 7 i LPP-së

Neni 8 i LPP-së

Neni 9 i LPP-së

Neni 27 i LPP-së.

\*\* Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kane qenë te rrejshme ose mashtruese.

## 8. Deklaratë detaile mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detauar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Të nderuar AK-ja me dt. 19.05.2021 ka publikuar tenderin me titull “Punimi dhe rregullimi i rrjetit furnizuese te ujësjellësit nga burimi në Kleq deri te rezervoari në fshatin Pllavë (projekt dy vjeqar)“.

Ju sqarojmë se në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit, ne gjatë analizimit të dosjes së tenderit dhe paramasës kemi vërejtur se ky aktivitet i prokurimit përmban paramasën me të dhënat dhe karakteristikat, e cila paramasë ka qenë e përfshirë në aktivitetin e prokurimit me titull Ujësjellësi Kryesor – Vazhdim i Punimeve (Projekt tre vjeçar) Nr. Prok: 621-17-2649-5-1-1, e i cili aktivitet akoma nuk ka marr epilog.

Pra projekti i ujësjellësit për fshatin Pllavë është pjesë e një tenderi i cili është akoma në procedurë administrative, prandaj AK-ja po bënë shkelje ligjore me këtë aktivitet të prokurimit, sepse nëse në aktivitetin e prokurimit Ujësjellësi Kryesor – Vazhdim i Punimeve (Projekt tre vjeçar) Nr. Prok: 621-17-2649-5-1-1 do të nënshkruhet kontrata pavarësisht nga cili operator ekonomik atëherë si do të veprohet në këtë rast. Operatori ekonomik nënshkrues eventual i kontratës “Ujësjellësi Kryesor – Vazhdim i Punimeve (Projekt tre vjeçar) Nr. Prok: 621-17-2649-5-1-1” është i obliguar të implementojë të gjithë paramasën që është parashikuar dhe përcaktuar, prandaj në këtë rast i bie se dy herë do të

realizohet e njëjta punë dhe shpenzimet do të jenë dyfish për autoritetin kontraktues. Madje nëse do të realizohej ky projekt për tenderin që është shpallur tani, atëherë OE nënshkrues i kontratës për projektin Ujësjellësi Kryesor – Vazhdim i Punimeve (Projekt tre vjeçar) Nr. Prok: 621-17-2649-5-1-1 do të realizonte fitimin edhe për këtë pjesë që janë kryer punimet.

Nga ky fakt, kuptohet që janë duke u zhvilluar dy aktivitete të prokurimit në të njëjtën kohë për punët e njëjta që kanë për tu realizuar, prandaj ky aktivitet i prokurimit duhet të anulohet dhe të vazhdohet me aktivitetin e prokurimit me titull “Ujësjellësi Kryesor – Vazhdim i Punimeve (Projekt tre vjeçar) Nr. Prok: 621-17-2649-5-1-1” ku është i përfshirë edhe projekti i tanishëm për Punimin dhe rregullimin e rrjetit furnizues te ujësjellësit për fshatin Pllavë.

Prandaj kërkojmë nga AK-ja që të korrigjoj këtë veprim dhe të anuloj në tërësi këtë aktivitet të prokurimit sepse aktiviteti i mëparshëm e ku është i përfshirë edhe ky projekt nuk ka marr epilog përfundimtar.

Në këtë rast AK-ja mund të bëjë vetëm shpenzime të paarsyeshëm dhe të panevojshme sepse fshati Pllavë do të furnizohet me ujë me realizmin e projektit të parashikuar në aktivitetin e prokurimit “Ujësjellësi Kryesor – Vazhdim i Punimeve (Projekt tre vjeçar) Nr. Prok: 621-17-2649-5-1-1.

Lidhshmërinë që është planifikuar në këtë projekt nuk mund të ketë efekt sepse rezervari ku është planifikuar të lidhet fshati Pllavë me ujë, nuk ka ujë të mjaftueshëm as për qytetin e Dragashit e leje më të zgjerohet furnizimi edhe me këtë fshat, pa u përfunduar kontrata “Ujësjellësi Kryesor – Vazhdim i Punimeve (Projekt tre vjeçar) Nr. Prok: 621-17-2649-5-1-1.

Po ashtu në aktivitetin e prokurimit me titull “Ujësjellësi Kryesor – Vazhdim i Punimeve (Projekt tre vjeçar) Nr. Prok: 621-17-2649-5-1-1”, është parashikuar që fshati Plavë të lidhet me rezervarin e njëjtë, mirëpo me kosto më të vogël dhe në afersi prej 1km, ndërsa me këtë projekt lidhshmëria me rezervarin është në gjatësi diku rreth prej 5.5 km, e që nënkupton se kostoja e shpenzimeve është disa herë më e madhe në këtë projekt se sa në projektin “Ujësjellësi Kryesor – Vazhdim i Punimeve (Projekt tre vjeçar) Nr. Prok: 621-17-2649-5-1-1”.

Andaj duke u bazuar në faktet e lartcekura kërkojmë nga AK-ja të anuloj në tërësi këtë aktivitet të prokurimit, pasi që i njëjti aktivitet vetëm dëmon tonë buxhetin e shtetit dhe gjithashtu duke e pasur parasysh edhe faktin se puna e njëjtë dhe me kosto më të vogël do të kryhet në projektin “Ujësjellësi Kryesor – Vazhdim i Punimeve (Projekt tre vjeçar) Nr. Prok: 621-17-2649-5-1-1.

Ju njostojmë se me dt.08.06.2021 ne kemi marr një përgjigje nga ana e AK-së në kërkesën për rishqyrtim, ku AK-ja thotë se ky projekt për te cilin ne kemi pretendime tona ankimore është projekt i veçantë dhe nuk ka të bëjë me projektin tjetër ekzistues.

Arsyetimi i AK-së në lidhje me kërkesën tonë për rishqyrtim ku e njëjta e ka cekur se “*Ky projekt ne zyrën tone ka ardhur nga ana e komunitetit te po këtij fshati. Projekti ne fjale është rrjeti i furnizimit me ujë te pijshëm që ka ekzistuar dhe që ekziston por me problem te pëlcitjes se gypave, andaj kësaj trase te vjetër do i shtohet gypi i rij dhe i projektuar e llogaritur sipas projektit te ofruar*”, nuk qëndron për faktin se nuk është i rëndësishëm se nga kush është propozuar projekt, sepse është e natyrshme që banorët të kérkojnë furnizim me ujë të pijshëm pa ndërprerje.

AK-ja ka qenë dhe është në dijeni se fshati Pllavë ka qenë pjesë e projektit të tenderit të vitit 2017, e i cili akoma nuk është përfunduar si procedurë, prandaj AK-ja është përgjegjëse për

vonesat e projektit të filluar në vitin 2017, e po ashtu është përgjegjëse edhe për projektin e filluar tani në mënyrë të kundërligjshme, sepse ka filluar një aktivitet të prokurimit i cili të ashtuquajtur tender mbi tender.

AK-ja e ka cekur se projekti në fjalë është projekt që ka ekzistuar dhe ekziston por me probleme të pëlcitjes së gypave, mirëpo ky arsyetim nuk qëndron sepse ne në kërkesën për rishqyrtim askund nuk e kemi cekur se nuk ekziston projekt, mirëpo e kemi qartësuar se punët e parapara në aktivitetin e prokurimit “Ujësjellësi Kryesor – Vazhdim i Punimeve (Projekt tre vjeçar) me Nr. Prok: 621-17-2649-5-1-1”, janë të njëjta me punët që do të kryhen në këtë aktivitet të prokurimit që e ka paraparë AK-ja dhe fshati Pllavë është i përfshirë në projektin e lartcekur. Pra duke u bazuar në këtë fakt kuptohet që janë duke u zhvilluar dy aktivitete të prokurimit në të njëjtën kohë për punët e njëjta që kanë për tu realizuar, prandaj ky aktivitet i prokurimit duhet të anulohet dhe të vazhdohet me aktivitetin e prokurimit me titull “Ujësjellësi Kryesor – Vazhdim i Punimeve (Projekt tre vjeçar) Nr. Prok: 621-17-2649-5-1-1” ku është i përfshirë edhe projekt i tanishëm për Punimin dhe rregullimin e rrjetit furnizues te ujësjellësit për fshatin Pllavë.

Ndërsa në lidhje me arsyetimin e AK-së se e njëjta është konsultuar edhe me përfaqësuesin e kompanisë Hidroregjioni, sektori në Dragash dhe se kinse i njëjti ka dhënë pëlqimin apo vërejtjet eventuale në lidhje me këtë projekt dhe sa i përket arsyetimit se kinse ky projekt nuk ka lidhshmëri me projektin komunal për 15 fshatrat e Komunës, por është projekt ekzistues qysh para shume viteve dhe qe është ende në funksion por me defekte të shpeshta, ku dhe ka qenë arsyaja pse po investohet në këtë projekt të kërkuar në investimet kapitale për këtë komunitet, ju sqarojmë se ky arsyetim i AK-së është tendencë për shmangje nga përgjegjësia e vetë AK-së dhe zhvendosja e vëmendjes tek institucionet tjera, e që realisht janë të parëndësishme dhe pa efekte mendimet dhe pëlqimet e institacioneve tjera për këtë aktivitet të prokurimit.

**Si dëshmi se projekt i këtij aktiviteti të prokurimit është i përfshirë edhe në projektin e tenderit “Ujësjellësi Kryesor – Vazhdim i Punimeve (Projekt tre vjeçar) Nr. Prok: 621-17-2649-5-1-1”, po ju bashkangjesim projektin e tenderit të shpallur në vitin 2017.**

Duke pasur parasysh të gjitha faktet që u cekën më lartë rezulton se nuk është bërë një planifikim dhe vlerësim i nevojave i saktë siç parashihet në nenin 8 dhe 9 të LPP-së, prandaj duhet anuluar ky aktivitet i prokurimit.

Duke u bazuar në faktet e lartcekura, rezulton se publikimi i këtij aktiviteti të prokurimit është i pa nevojshëm dhe në këtë mënyrë nuk mund të arrihet qëllimi i LPP-së, siç parashihet në nenin 1 të këtij ligji, e ku shkruan qartë: *Qëllimi i këtij ligji është të siguroj mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondevë publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondevë dhe burimeve të tjera të autoritetetëve kontraktuese në Kosovë.*

Duke u bazuar në të gjitha faktet dhe dëshmitë që u cekën më lartë, kërkojmë nga OSHP-ja që të merr:

## V E N D I M

**APROVOHET**, si e bazuar ankesa e OE “PUNA” Sh.p.k

**ANULOHET**, njoftimi për kontratë dhe anulohet në tërësi ky aktiviteti i prokurimit.

Nëse nuk merren parasysh faktet tona, ne jemi të detyruar të vazhdojmë procedurën ligjore në institucionet tjera kompetente.

## **9. Dëmet materiale**

*Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.*

Neve si Operator Ekonomik na janë bërë dëme materiale për përgatitjen dhe dorëzimin e ofertës, për kërkesën për rishqyrtim në vlerë prej 5,000.00 euro.

## **10. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura**

*Nëse aplikohet, bashkëngjitni kërkesës dokumentet e renditura më poshtë:*

- a) një kopje të publikimit të “Njoftimit për Kontratë” apo “Njoftimit për Konkurs të Projektimit.
- b) një kopje të publikimit për “Njoftimin e Dhënies së Kontratës” apo “Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimit për Anulim”.
- c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.
- d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet.

*\*\*\*Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*